



#01023

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Instituti i Statistikave (INSTAT), kërkon të punësojë punonjës me kontratë pune në pozicionet: Koordinator Administrativ

TITULLI I SHPALLJES "KOORDINATOR ADMINISTRATIV"

Termet e referencës:

Pergjgjes për të koordinuar, monitoruar dhe lehtësuar zbatimin e projektit financuar nga Ambasada Suedeze në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Koordinatorit Administrativ janë:

1. Të monitorojë dhe të ndjekë zbatimin e projektit. Në bashkëpunim me INSTAT, Njësia IPA për projektin e BE -së dhe Ambasada do të mbështesin dërgimin e inputeve dhe rezultateve të projektit.
2. Të bashkëpunojë dhe mbështesë punën midis departamenteve e përgjegjëse të INSTAT dhe ekipit të Censit për përmbushjen në kohë të aktiviteteve të projektit duke përfshirë procedurat për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të mbuluara nga projekti.
3. Të mbështesë INSTAT në koordinimin e aktiviteteve me donatorë dhe projekte të tjera.
4. Të monitorojë menaxhimin financiar të projektit në përputhje me procedurat teknike, bazuar në marrëveshjen midis INSTAT dhe Ambasadës Suedeze . Të sigurojë që disbursimi i fondeve të jetë në përputhje me termet e referencës të miratuara.
5. Të përgatisë draft raportin narrativ të projektit në bashkëpunim me ekipin e projektit.
6. Të lehtësojë raportimin, rishikimin e buxhetit dhe planit të aktiviteteve në përputhje me projekt dokumentin e miratuar.
7. Të rishikojë buxhetin dhe planin e aktivitetit në përputhje me projekt dokumentin e miratuar.
8. Të mbështesë organizimin e takimeve të Komitetit Drejtues të Projektit dhe takimet vjetore midis INSTAT dhe Ambasadës Suedeze.
9. Të sigurojë që auditimi vjetor i projektit të kryhet në kohë dhe në përputhje me kërkesat e Sida-s /Ambasadës Suedeze sipas marrëveshjes midis INSTAT dhe Ambasadës.
10. Të kryejë detyra të tjera që lidhen me projektin.

Kriteret e përzgjedhjes:

- Ekspertizë dhe përvojë e provuar në menaxhimin dhe zbatimin e projektit, jo më pak se 5 vjet në total.
- Eksperiencë pune me administratën publike dhe me donatorë, jo më pak se 7 vjet së bashku. Preferohet me përvojë të mëparshme dhe njohuri në procedurat e prokurimit.
- Diplomë universitare në Shkenca: Shoqerore/ Sociale/ Ekonomike. Diplome ne Master Shkencor është gjithashtu e preferueshme.
- Zotërim i mirë në të folur dhe shkruar i gjuhës angleze.
- Njohuri dhe përvojë të mirë të programeve dhe funksioneve kompjuterike
- Aplikanti duhet të jetë i vetë-motivuar dhe të zotërojë aftësi të mira komunikimi, aftësi organizative, aftësi të mira

raportimi dhe nivel të lartë të ndërgjegjësimit për çështjet e transparencës dhe integritetit.

Informacione te tjera:

Afati i aplikimit:9/30/2021

Aplikimi realizohet nëpërmjet faqest së Institutit të Statistikave në seksionin e vëndeve vakante për pozicionet me kontrata të përkohëshme.

Ju duhet të hyni / rregjistroheni më parë në sistem për të aplikuar për këtë pozicion pune
(<http://rekrutime.instat.gov.al/aplikant>)